Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 286/19
Datë/Datum. 23.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 286/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: NTP "Medica" ShPK, - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë konzorciumi: ''Roymed & Kosova Med "- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: "Furnizim me Material Shpenzues nga Lista Esenciale për FSSH", me numër të prokurimit 206-19-24-111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Ministria e Shëndetësisë, /MSH/, më datën: 03.07.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik NTP "Medica" ShPK, - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Material Shpenzues nga Lista Esenciale për FSSH", me numër të prokurimit 206-19-24-111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Ministria e Shëndetësisë, /MSH/.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: "Furnizim me Material Shpenzues nga Lista Esenciale për FSSH", me numër të prokurimit 206-19-24-111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, /MSH/, dhe lënda kthehet ne **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NTP "Medica" ShPK, - Prishtinë, aprovohet si pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e publikimit të njoftimit për kontratë është bërë me dt: 28.01.2019.
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 15.03.2019
Data e Kërkesa për rishqyrtim është bërë me dt: 17.05.2019.
Data e vendimit të Autoriteti Kontraktues MSH,lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 31.05.2019 .

Operatori ekonomik ankues NTP "Medica" ShPK, - Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 07.06.2019, me nr. 286/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Material Shpenzues nga Lista Esenciale për FSSH", me numër të prokurimit 206-19-24-111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues –Ministria e Shëndetësisë, /MSH/ , duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,7, 59, 60,71,dhe 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 18, dhe 27, të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 14.06.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit si dhe ekspertin të jashtëm teknik për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti i jashtëm teknik dhe eksperti shqyrtues në raportin e dt: 20.06.2019, Sqaron: Autoriteti Kontraktues /Ministria e Shëndetësisë (MSH), gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të

hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike (kornizë – 12 muaj) me vlerë të madhe. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës.
Kundër të njëjtit propozim parashtruesi i ankesës OE "Medica" ShPK, me datën 17.05.2019, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK – MSH, me pretendimet e njëjta ankimore si në OSHP, përderisa AK – MSH, me datën 31.05.2019, përmes përgjigjes, ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimore. nr. 1 (Neni 113) OE ankues pretendon që OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbush kërkesën e AK-së që e obligon të instalojë printerët pasi që ka kërkuar qasje direkte në pajisje si dhe username dhe password për të bërë instalimin dhe kjo përbën ndryshim material apo devijim sipas OE ankues.
Eksperti teknik sqaron se pasi që printerët duhet të instalohen në pajisjet e AK-së përkatësisht njësive spitalore të specifikuar si në dosjen e tenderit është evidente që për instalimin e tyre, janë të domosdoshme kredencialet (username dhe password) që kanë autorizim për të bërë instalimin (zakonisht kredencialet e Administratorit), kjo pjesë e deklaratës nuk e ndryshon materien e kërkesës, mirëpo e kushtëzon teknikisht instalimin duke potencuar nevojën për sigurimin e qasjes adekuate me nivel të autorizimit përkatës, për të bërë instalimin, transferimin e fajllave programor të pajisjes periferike, në këtë rast printerëve dhe komunikimin respektiv ndërmjet pajisjeve për të kryer funksionin. Andaj, bazuar në sqarimin e mësipërm, pretendimi ankimor është i paqëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimet ankimore:nr. 2.OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontrate ka lidhshmëri me grupin e OE "Kosovamed Helathcare" dhe "Olgun MedikalInşaat" dhe kjo bie në kundërshtim me LPP, përkatësisht nenin 71, pasi që z. Kastriot Asllani është pronar i kompanisë "Kosovamed Helathcare" dhe menaxher operacional tek kompania "Raymed".

Sipas shkresave të lëndës rezulton që emri i njëjtë i z. Kastriot Asllani, të jetë i përshkruar tek informatat e biznesit dhe përmes shkresave tjera, (edhe pse nuk mund të konfirmohet nëse bëhet fjalë për të njëjtin person, pasi që nuk kishim të dhëna tjera) tek kompania "Kosovamed Helathcare", dhe "Raymed" (Kosovamed Helathcare" dhe "Olgun MedikalInşaat", kanë ofertuar në grup). Sipas paragrafit 2, të nenit 71, të LPP-së, përcaktohet se, nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklarate të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit. Të gjitha autoritetet kontraktuese duhet që ta parashtrojë këtë kusht në dosjet e

tyre të tenderit. Në rast së një anëtar merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm.

Përgjigje në pretendimet ankimore:nr. 3. OE ankues pretendon se AK MSH ka bërë shkelje duke pranuar si të përgjegjshme ofertën e OE të rekomanduar për kontratë pasi që dokumentet janë nënshkruar nga ana e personave jo kompetent për nënshkrim të ofertës dhe te cilët po ashtu nuk kanë prezantuar asnjë autorizim nga OE se kanë këtë të drejtë.
Sipas ofertës së OE, përkatësisht tek informatat e biznesit të kompanisë "Kosovamed" shpk dhe "Raymed"shpk, (të njëjtat kompani kanë dorëzuar ofertë në Grup) ku në te dy kompanitë sipas të dhënave në certifikatën e biznesit si, pronar është z. Xhavit Asllani, përderisa oferta dhe marrëveshja e themelimit të Grupit – Konzorciumit, është lidhur nga persona tjetër përkatësisht nga Leke Kastrati dhe Nderim Kerleshi, ndërsa në ofertë nuk kemi hasur që të njëjtit kanë qenë të autorizuar që të krijojnë dhe dorëzojnë oferte. Sipas nenit 18.3, të Rregullave të UOPP-së, përcaktohet që "...Në rast se personi që nënshkruan dhe dorëzon ofertën nuk është personi kompetent për nënshkrim të ofertës (drejtori i kompanisë), por është i autorizuar nga OE, OE duhet që të dorëzoj me ofertën e tij autorizimin për nënshkrim të ofertës, përndryshe oferta e tij do të refuzohet. AK obligohet që këtë kërkesë ta përcaktoje në DT.

Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti shqyrtues / teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues – NTP "Medica" ShPK - Prishtinë të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa propozimi për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Operatori ekonomik NTP "Medica" ShPK, - Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 21.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues MSH, përmes parashtresës me shkrim të datës: 24.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 03.07.2019, ku kanë qenë prezent kryetari i paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së, eksperti shqyrtues dhe teknik, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të

ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Merovci deklaroj: N.T.P." Medica" Pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit, ku kemi pasur 3 pretendime ankimore, deklarojmë se për pretendimin nr 1. Nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit pasi qe konsiderojmë qe nuk është shqyrtuar ne mënyrë te drejt për arsye se, ne këtë rast kemi te bëjmë me printer medicinal dhe jo printer administrative dhe për lidhjen e këtyre printerëve nuk nevojitet username dhe password pasi kemi te bëjmë me konfigurim ne pajisje direkt dhe ne Spitalet e Kosovës pajisjet ku duhet te lidhen janë mbi 10 prodhues te ndryshëm dhe konfigurimi ne to dallon varësisht prodhuesit, tek disa prodhues kërkohet vetëm password i cili nuk ndryshohet asnjëherë, tek disa prodhues paswordad janë me afat dhe ne çdo kohe duhet te blihet i riu ne disa pajisje nuk nevojitet password po vetëm aftësi e stafit për lidhje te printerëve. OE i rekomanduar për kontrate ka deklaruar se do te lidhe printerët ne rast se AK i siguron passwordt, pra ka ndryshim material te dosjes pasi qe ne dosjen e tenderi ky kriter është kërkuar qe OE mbajnë të gjithë përgjegjësin për lidhje mirëmbajte servisim te printerëve. Dhe ne këtë rast sipas deklaratës e OE te rekomanduar AK duhet te ushtroj mbi 10 aktivitete te prokurimit për sigurimin e këtyre passwordve pasi qe te gjithë këta kane kosto, gjithë ashtu një numër i pajisjeve janë modele te vjetra ku edhe ne tregun tone nuk ka kompani qe përfaqësojnë këta prodhues ku edhe sigurimin i passwordve nga ana e AK është i pa mundeshem. Ky kriter është nder kryesoret pasi qe ne rast mos lidhja e printerëve nënkupton dëmtim te buxhetit pasi qe AK me ne baze te LPP është i obliguar qe minimum 70% të bej porosi dhe ne këtë rast mos lidhja e printerëve nënkupton qe një pjese e madhe e filmave duhet të hudhen nga AK pasi edhe këto si produkte janë me afat skandence. Gjithashtu edhe ne piken tjetër te Deklaratës OE ka deklaruar se do te bej Brenda 30 ditëve liferimin, instalimin dhe lëshimin ne pune te printerëve (aty ku është e nevojshme dhe kërkesës e AK) kurse ne dosjen e tenderit shkruan shume qarte ne forme tabelore se sa është numri i printerëve qe duhet te sillen dhe te instalohen pra edhe ne këtë pike ka ndryshim te material pasi OE deklaron do te instalojmë aty ku është e nevojshme dhe kërkesë e AK, kurse ne dosje te tenderit është specifikuar shume qartë me ane te tabelës se ku duhet te liferohen dhe instalohet këta printer Brenda afatit 30 ditë.
OE MEDICA pajtohet me për mendimin e ekspertit për pretendimet 2 dhe 3 ne rast se Eksperti Shqyrtues këta pretendime i ka konsideruar si te qëndrueshme pasi qe ne raportin e ekspertit ne këto pretendimet 2 dhe 3 nuk kemi para mendimin e ekspertit shqyrtues, vetëm mendimin përfundimtare qe lëndë atë kthehet ne rivlerësim. Pra ne këto 2 pretendime shihet qarte se kemi te bëjmë me një grup te lidhur dhe gjithë ashtu kemi te bëjmë me nënshkrimin e dokumentacionit nga persona te pa autorizuar.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Thaçi deklaroj: Ne si Autoriteti Kontraktues pajtohemi me pikat te cilat i ka aprovuar ne raport te ministrisë eksperti, për piken 1 nuk qëndrojnë pasi qe OE te rekomanduar për kontrate ne ofertën e tij ka deklaruar se do te instaloj dhe te lidh pajisjet ekzistuese, ne afat prej 30 ditëve si qeshet kërkuar ne DT, Grupi ekonomik ka deklaruar se do te bej instalimin e pajisjeve dhe trajnimin e personelit pas nënshkrimit te kontratës, për këtë arsye pretendimi ankimor ne piken 1 nuk qëndron pasi qe Grupi i OE i rekomanduar për kontrate aty ku është e nevojshme dhe kërkesa e Autoriteti Kontraktues do te furnizoj me printer siç është afati i liferimit. Për piken 2 pika 2 nuk qëndron Autoriteti Kontraktues ka kërkuar Certifikatën IZO jo raportin e Auditimit si i tille, Raporti i Audititmit është raport i panevojshëm për Autoriteti Kontraktues ,kërkesa e Autoriteti Kontraktues ka qen për IZO, Ankuest i referohen një dokumenti qe është lëshuar ne mars te vitit 2018 ne i kemi verifikuar te gjitha dokumentet tjera ku nuk figuron me menaxhment personi ne fjale. Bazuar ne piken 3 nuk qëndron, duke u bazuar ne nenin 72 te LPP-së kemi kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontrate ku ka ofruar dëshmi kontratat e punës për te 2 menaxheret, pasi qe ne deklaratën për konsorcium kanë përfaqësuesit e tyre qe janë menaxher te këtyre 2 kompanive, po ashtu duhet te ketë parasysh se për Lot 1 OE ankues është me i shtrejt për 14.117 euro ndërsa për Lot 2 25.464.60 euro

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues z. Bibaj deklaroj: Sa i përket aspektit ligjor ne pretendimet ankimore i kemi trajtuara si te bazuara gjithnjë sipas pretendimeve ankimore pasi qe për këtë AP ka oferta qe kanë ofertuar ne konsorcium dhe sipas kësaj rezulton se Emri i personit te caktuar fizik te jetë ne njërën ane pronar dhe ne anenë tjetër Menaxher për te dy ofertat një gjë e tillë sipas paragrafi .2 te nenit 71 te LPP-së, nuk lejohet te ofrojnë me 2 oferta, pretendimi tjetër ka te bej me dorëzim ose nënshkrim te ofertës se OE i propozuar për dhënie te kontratës ku e njëjta oferte nuk është dorëzuar nga pronari i kompanisë por nga zyrtar te tjerë te kompanisë ndërsa ne shkresa te ofertës nuk ka pasur autorizim qe te njëjtit munden te dorëzojnë oferte edhe ky veprim sipas nenit 18.3 te RrUOPP-së, është i ndaluar, për pretendimet teknike vazhdon kolegu Spahiu si ekspert Teknik.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Teknik z. Spahiu deklaroj: Eksperti teknik thekson se qëndron pranë raportit të ekspertizës. Më tej eksperti sqaron se pasi që printerët duhet të instalohen në pajisjet e AK-së përkatësisht njësive spitalore të specifikuar si në dosjen e tenderit është evidente që për instalimin e tyre, janë të domosdoshme kredencialet (username dhe password) që kanë autorizim për të bërë instalimin (zakonisht kredencialet e Administratorit), kjo pjesë e deklaratës nuk e ndryshon materien e kërkesës, mirëpo e kushtëzon teknikisht instalimin duke potencuar nevojën për sigurimin e qasjes adekuate me nivel të autorizimit përkatës, për të bërë instalimin, transferimin e fajllave programor të pajisjes periferike, në

këtë rast printerëve dhe komunikimin respektiv ndërmjet pajisjeve për të kryer funksionin. Andaj, bazuar në sqarimin e mësipërm, pretendimi ankimor është i paqëndrueshëm. Ne aspektin teknik është e refuzuar ankesa, ndërsa ne aspektin administrativ është ne rregull.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Merovci deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues qe te obligoj AK qe lëndën ta kthej ne rivlerësimin dhe te marr parasysh pretendimet tona si te qëndrueshme dhe OE i rekomanduar për kontrate te shpallet i papërgjegjshëm .

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Thaçi deklaroj: I propozojmë panelit te mbetet ne fuqi vendimi i AK.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, dhe ekspertit teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues NTP "Medica" ShPK, - Prishtinë, pretendon që OE i rekomanduar për kontratë ''Roymed & KosovaMed – Prishtinë, nuk e ka përmbush kërkesën e AK-së, që e obligon të instalojë printerët pasi që ka kërkuar qasje direkte në pajisje si dhe username dhe password për të bërë instalimin dhe kjo përbën ndryshim material apo devijim sipas OE ankues .
Paneli shqyrtues konform eksperti të jashtëm teknik konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i paqëndrueshëm, për faktin se printerët duhet të instalohen në pajisjet e AK-së, përkatësisht njësive spitalore të specifikuar si në dosjen e tenderit është evidente që për instalimin e tyre, janë të domosdoshme kredencialet (username dhe password) që kanë autorizim për të bërë instalimin (zakonisht kredencialet e Administratorit), kjo pjesë e deklaratës nuk e ndryshon materien e kërkesës, mirëpo e kushtëzon teknikisht instalimin duke potencuar nevojën për sigurimin e qasjes adekuate me nivel të autorizimit përkatës, për të bërë instalimin, transferimin e fajllave programor të pajisjes periferike, në këtë rast printerëve dhe komunikimin respektiv ndërmjet pajisjeve për të kryer funksionin.

Sa i përket pretendimit të OE ankues NTP "Medica" ShPK, - Prishtinë, se OE i rekomanduar për kontrate ''Roymed & KosovaMed – Prishtinë, ka lidhshmëri me grupin e OE "Kosovamed Helathcare" dhe "Olgun MedikalInşaat" dhe kjo bie në kundërshtim me LPP, përkatësisht nenin 71, pasi që z. Kastriot Asllani është pronar i kompanisë "Kosovamed Helathcare" dhe menaxher operacional tek kompania "Raymed".
Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues sqaron se sipas shkresave të lëndës rezulton që emri i njëjtë i z. Kastriot Asllani, të jetë i përshkruar tek informatat e biznesit dhe përmes shkresave tjera, (edhe pse nuk

mund të konfirmohet nëse bëhet fjalë për të njëjtin person, pasi që nuk kishim të dhëna tjera) tek kompania "Kosovamed Helathcare", dhe "Raymed" (Kosovamed Helathcare" dhe "Olgun MedikalInşaat", kanë ofertuar në grup). Sipas paragrafit 2, të nenit 71, të LPP-së, përcaktohet se, nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklarate të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit. Të gjitha autoritetet kontraktuese duhet që ta parashtrojë këtë kusht në dosjet e tyre të tenderit. Në rast së një anëtar merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm.

Sa i përket pretendimit të OE ankues NTP "Medica" ShPK, - Prishtinë, se autoriteti kontraktues MSH, ka bërë shkelje duke pranuar si të përgjegjshme ofertën e OE të rekomanduar për kontratë pasi që dokumentet janë nënshkruar nga ana e personave jo kompetent për nënshkrim të ofertës dhe te cilët po ashtu nuk kanë prezantuar asnjë autorizim nga OE se kanë këtë të drejtë.
Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues sqaron se sipas ofertës së OE, përkatësisht tek informatat e biznesit të kompanisë "Kosovamed" shpk dhe "Raymed"shpk, (të njëjtat kompani kanë dorëzuar ofertë në Grup) ku në te dy kompanitë sipas të dhënave në certifikatën e biznesit si, pronar është z. Xhavit Asllani, përderisa oferta dhe marrëveshja e themelimit të Grupit – Konzorciumit, është lidhur nga persona tjetër përkatësisht nga z.Leke Kastrati dhe z.Nderim Kerleshi, ndërsa në ofertë nuk kemi hasur që të njëjtit kanë qenë të autorizuar që të krijojnë dhe dorëzojnë oferte. Sipas nenit 18.3, të Rregullave të UOPP-së, përcaktohet që "...Në rast se personi që nënshkruan dhe dorëzon ofertën nuk është personi kompetent për nënshkrim të ofertës (drejtori i kompanisë), por është i autorizuar nga OE, OE duhet që të dorëzoj me ofertën e tij autorizimin për nënshkrim të ofertës, përndryshe oferta e tij do të refuzohet. AK obligohet që këtë kërkesë ta përcaktoje në DT.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës si dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit profesional teknik, konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht obligon autoritetin kontraktues MSH, që gjatë rivlerësimit konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, të vërtetoj dhe të kërkojë sqarime shtesë se dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë konzorciumi: ''Roymed & KosovaMed - Prishtinë, a janë ne pajtim me nenin 71 të LPP-së, si dhe me nenin 18.3 të Rregullave të UOPP-së. Gjithashtu të vërtetojë se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë konzorciumi në fjalë a i ka plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit dhe të njoftimit për kontratë ashtu siç ka kërkuar autoriteti kontraktues në FDT.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Ministria e Shëndetësisë

1x1 OE- NTP "Medica" ShPK, - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.